

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7076
E enjte, 21 dhjetor 2023
Çmimi 0.50 €

Betohen 17 vullnetarët e rinj të Korpusit të Paqes në Kosovë



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-SË SI "ORGANIZATË TERRORISTE"? (16)

DEKLARATA POLITIKE NUMËR 7 I HAPI DYERT E DIPLOMACISË

AKTUALE



TRUMPI SHKUALIFIKOHET PËR ZGJEDHJET PRESIDENCIALE NË KOLORADO

ZELENSKY: USHTRIA UKRAINASE KËRKON 500 000 USHTARË SHITESË

SVEÇLA PËR KOMPLEKSIN NË BANJSKË: DESTINACIONIN FINAL DO T'IA PARACAKTOJMË NDRËKOHË

EKONOMI



MBAHET KONFERENCA VJETORE E MINISTRISË SË INDUSTRIISË: QEVERIA, PLATFORMË NDIHMUESE PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT PRIVAT

KOMUNA E GJILANIT MBËSHKETET KËRKESËN PËR LIRIMIN E BIZNESEVE NGA TAKSA KOMUNALE PËR VITIN 2023

SPORT



DRITA FITON DERBIN NDAJ BALLKANIT, DIFERENCA SHKURTOHET NË PESË PIKË



Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë "Epokës së re", në vazhdimin e pjesës së gjashtëmbëdhjetë, ka folur për Deklaratën politike nr. 7, të datës 13 gusht 1998, ku Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së publikoi emrat e

përfaqësuesve politikë. Ai ka treguar se krijimi i Drejtorisë Politike kishte për qëllim ta administronte dimensionin politik të luftës çlirimtare dhe në funksion të qartësimit se kush e përfaqëson UÇK-në. "Publikimi i emrave të përfaqësuesve politikë hoqi një numër dilemash që shtroheshin qoftë gjatë konferencave të shtypit me

gazetarë të medieve të ndryshme ndërkombëtare, qoftë në zgjerimin e kontakteve me diplomatë të vendeve të ndryshme", ka thënë Bardhyl Mahmuti. Në këtë intervistë ai flet edhe për pakënaqësitë brenda LPK-së sa iu përket emrave se kush do të duhej ta përfaqësonte UÇK-në në takime me diplomatët e huaj

IKD DHE FOL: KOMISIONI I VENECIAS S'I PËRKRAHU NDRYSHIMET E MD-së PËR RITJEN E PËRKOSSHME TË ANËTARËVE TË KPK-së



PARALAJMËROHET ASHPËRSIM I MASAVE PËR SHKELËSIT E RREGULLAVE NË TRAFIK



RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepcisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Trumpi shkualifikohet për zgjedhjet presidenciale në Kolorado

WASHINGTON, 20 DHJETOR - Gjykata Supreme e Kolorados ka marrë vendim që ish-presidenti amerikan Donald Trump nuk mund të garojë në zgjedhjet e ardhshme presidenciale, duke e cituar një klauzolë kushtetuese për kryengritje.

Gjykata ka marrë vendim që Trumpi nuk është kandidat i përshtatshëm, sepse është përfshirë në kryengritje, gjatë trazirave që kanë ndodhur në Kongresin amerikan tre vjet më parë.

Fushata e Trumpit e ka cilësuar vendimin si antidemokratik dhe është zotuar se do ta apelojë atë. Kjo është hera e parë që interpretohet një pikë e Amadamentit të 14-të Kushtetutës amerikane, për ta shkualifikuar një kandidat për president.

Tentime të ngjashme për ta pamundësuar garën e Trumpit në Nju-Jork, Minesota dhe Miçigan,

kanë dështuar.

Vendimi i së martës - i cili është vënë në mbajtje deri në vendimin e apelit, muajin tjetër - nuk vlen për shtetet e tjera, përveç Kolorados. Ky vendim vlen vetëm për votimet fillestare të 5 marsit, kur republikanët të votojnë për kandidatit e tyre të pëlqyer për president, ndonëse vendimi mund të ketë ndikim në zgjedhjet e përgjithshme të ShBA-së që mbahen në nëntorin e vitit të ardhshëm.

Gjyqtarët kanë thënë se vendime të tilla nuk i marrin lehtë. "Ne jemi të vetëdijshëm për shkallën dhe peshën e pyetjeve që kemi përpara vetes".

Ky vendim përbys një vendim tjetër të një gjyqtari në Kolorado, i cili ka vendosur se ndalesa që përmendet në Amendamentin e 14-t nuk vlen për presidentët, sepse ata nuk përmenden aty në mënyrë specifike.



I njëjti gjyqtar pati gjetur se Trumpi ka marrë pjesë në kryengritjen ndaj Kongresit.

Mbështetësit e tij kanë kryer trazira më 6 janar të vitit 2021 në këtë ndërtesë, derisa ligjvënësit kanë

qenë duke e certifikuar fitoren e presidentit aktual Joe Biden.

Përfaqësuesit e fushatës së Bidenit nuk e kanë komentuar vendimin e Kolorados.

Aktualisht Trumpi po përballet me

katër raste penale nëpër gjyq, përfshirë një rast federal, dhe një padi tjetër në shtetin e Xhorxhias, lidhur me dyshimet se ka bërë përpjekje për përmbyse të rezultatit zgjedhor.

Zelensky: Ushtria ukrainase kërkon 500 000 ushtarë shtesë

KIEV, 20 DHJETOR - Ushtria ukrainase synon të mobilizojë edhe 500 000 ushtarë shtesë, ka thënë presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky, teksa lufta me Rusinë mbush gati dy vjet.

Në një konferencë për media në Kiev, ai ka thënë se komandantët e tij po kërkojnë "450 000 - 500 000 individë", duke pranuar se kjo çështje është "e ndeshme" dhe e kushtueshme.

Ai ka thënë se i duhen më shumë hollësi para se të përkrahë këtë vendim, duke dhënë shenja se rreth 500 000 ushtarë veçse janë në front të luftës.

Komentet e tij kanë ardhur teksa rrezikohet ndihma e Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit



Evropian për vendin e tij.

Republikanët në Kongresin amerikan e kanë bllokuar fillimisht një paketë ndihme në vlerë të 60 miliardë dollarëve për Ukrainën.

Këtë javë përfaqësuesit e Shtëpisë

së Bardhë dhe Departamentit Amerikan të Shtetit kanë thënë se planifikojnë të dërgojnë më shumë pako të ndihmës për Ukrainën, mirëpo kanë pak kapacitet për të çuar diçka përpara në mungesë të

gatishmërisë së Kongresit.

Blokada në ShBA u përcoll me një bllokadë që Hungaria ia ka vënë BE-së për të dërguar ndihmë në vlerë të 50 miliardë eurove për Ukrainën.

Megjithatë, liderët e BE-së kanë thënë se Ukraina nuk do të mbesë pa mbështetje.

Ukraina po përballet me mungesë municioni, teksa vazhdon të luftojë me ushtrinë ruse, pas nisjes së luftës së Moskës në Ukrainë, në shkurt të vitit 2022.

Kundërofensiva e Kievit nuk ka arritur rezultatet e kërkuara përgjatë verës.

Presidenti rus Vladimir Putin insiston se Moska do ta vazhdojë pushtimin dhe është zotuar se do

të arrihen të gjitha synimet.

Lideri i Kremlinit ka thënë se 617 000 ushtarë rusë janë duke marrë aktualisht në atë që Moskë e quan "operacion special ushtarak". Megjithatë, ai e ka pranuar se forcat e tij ushtarake kanë probleme me sistemet ajrore për mbrojtje dhe komunikime dhe se duhet rritur prodhimin e dronëve.

Putini e quan luftën si "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Rosisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Vendet e BE-së pajtohen për t'i ashpërsuar rregullat për azil

BRUKSEL, 20 DHJETOR - Vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe Parlamenti Evropian janë pajtuar që t'i ashpërsojnë procedurat e azilit në kuadër të reformës evropiane për sistemin e azilit.

Qëllimi i marrëveshjes është që të zvogëlohet shkalla e migrimit në BE. "Kemi bërë rrugë të gjatë për të arritur këtu. Por, ia kemi dalë. Evropa është më në fund e përkushtuar ndaj migrimit", ka thënë zëvendëspresidenti i Komisionit Evropian, Margaritis Schinas, në një postim në "X".

Presidentja e Parlamentit Evropian, Roberta Metsola, ka

thënë se kjo ditë e mërkurë "do të hyjë në histori". "Dita kur BE-ja ka arritur marrëveshje për rregulla të reja për menaxhim të migrimit dhe azilit".

Reforma është diskutuar qysh prej vitit 2015, kur një numër rekord migrantësh kanë arritur në BE.

Ndonëse shtetet në qeveri të krahut të djathtë, sikurse Hungaria, kanë qenë në të mirë të ashpërsimit të rregullave aktuale, organizatat për ndihmë dhe partitë politike të së majtës në Evropë, kanë shprehur shqetësim për degradim të të drejtave të njeriut. Reforma "do të garantojë që

ekziston përgjigje efektive evropiane për këtë sfidë evropiane", ka thënë shefja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen.

"Kjo do të thotë se evropianët do të vendosin se kush vjen në BE dhe kush mund të qëndrojë këtu, jo kontrabanduesit", ka thënë ajo. Reforma parashihet rregulla më të ashpra për njerëzit që arrijnë në territorin e BE-së nga vendet që konsiderohen relativisht të sigurta. Derisa të merret një vendim ligjor për ta, azilkërkuesit do të strehohen nëpër disa qendra, nën rregulla strikte.



Sveçla për kompleksin në Banjskë: Destinacionin final do t'ia paracaktojmë ndërkohë

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës, Xhelal Sveçla, ka thënë të mërkurën se Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) është pronare e kompleksit "Rajska Banja" në Banjskë të Zveçanit. "Për këtë [pronësinë] nuk ka asnjë dyshim. Pse dikush ka investuar jashtëligjshëm, mendoj se është mësim për të gjithë ata të cilët dëshirojnë të investojnë jashtëligjshëm, se nuk mund ta bëjnë. Sa i përket menaxhimit të atij kompleksi, Ministria e Punëve të Brendshme është rezultat i bashkimit të dy ministrive, të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Administratës Publike, e ish-Ministria e Administratës Publike e ka Departamentin e Menaxhimit të objekteve të këtuja, në pronësi të shtetit. Kjo është arsyeja pse e kemi marrë në menaxhim, dhe destinacionin final këtij objekti do t'ia paracaktojmë ndërkohë", ka thënë Sveçla.

AKP-ja i ka thënë të martën "Radios Evropa e Lirë" se e ka marrë nën administrim këtë kompleks, pasi prona i përket një



ndërmarrjeje shoqërore të Kosovës dhe të njëjtin ia ka lëshuar me qira Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Drejtori menaxhues i AKP-së, Arben Limani, ka thënë se janë bërë përpjekje për të kontaktuar me personat apo entitetet që e

kanë shfrytëzuar këtë pronë, por nuk kanë marrë përgjigje, andaj kanë kërkuar asistencën e Policisë së Kosovës që ta marrin

nën administrim këtë pronë, që gjendet në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe. "Pronat e kompleksit në Banjskë janë prona të Ndërmarrjes Shoqërore 'Trepça Standard', që ka selinë në Mitrovicë të Veriut, dhe prona është në emër të kësaj njësie dhe objekti që ka ekzistuar aty. Sipas të gjitha gjasave, dikush e ka rinovuar objektin gjatë një periudhe, të cilën ne nuk e dimë, sepse atje kemi pasur qasje mjaft të kufizuar. Kurse tash, kur kemi marrë qasje atje, kemi tentuar të kontaktojmë me personat apo entitetet atje që e kanë shfrytëzuar atë, në mënyrë që të kuptojmë se mbi çfarë baze ligjore e kanë shfrytëzuar atë", ka thënë Limani. Sipas tij, policia i ka dhënë AKP-së informacione se në këtë kompleks ka pasur aktivitete të paligjshme. Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar, ka reaguuar pas aksionit në Banjskë, duke thënë se Qeveria e Albin Kurtit "rrëmbeu" kompleksin në Banjskë "para syve të komunitetit ndërkombëtar".

Paralajmërohet ashpërsim i masave për shkelësit e rregullave në trafik

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Ministri i Brendshëm, Xhelal Sveçla, ka paralajmëruar të mërkurën ashpërsim të masave për shkelësit e rregullave në trafik. Ai ka përmendur se ditët e fundit kanë vdekur katër individë nga aksidentet në trafik, tre prej tyre si pasojë e garave të jashtëligjshme automobilistike në autostradën "Ibrahim Rugova" në Prizren.

Sveçla ka thënë se përmes masave që do të merren ndaj shkelësve, masa do të ketë edhe ndaj, siç ka thënë ai, neglizhencës së zyrtarëve policorë për trajtim me prioritet të garave të paligjshme.

Ai ka thënë se vetëm këtë vit janë dhënë 76 gjoba ndaj personave që kanë organizuar gara të tilla, që shkaktojnë rrezik të përgjithshëm në komunikacion.

Sveçla ka thënë se në kuadër të ndryshimeve në ligjin për trafik do të kërkojë që garat e paligjshme të konsiderohen vepër penale. "Policia e Kosovës të njëjtin grup e kishte parandaluar dy herë në organizmin e garave të tilla. Siç tashmë është bërë publike në shumë medie, të njëjtin kanë pasuar gjoba të njëpasnjëshme



për tejkalim shpejtësie, dhe njërit i është konfiskuar patentë-shoferi për filmim dhe publikim të këtyre garave".

Ai ka thënë se tashmë është "inicuar hetim disiplinor për përgjegjësi menaxheriale, janë lëvizur dy komandantë të njëjësive

të trafikut, dhe është krijuar plan i ri operativ për trafikun rrugor". Sveçla ka thënë se është miratuar në lexim të parë në

Kuvendin e Kosovës ligji për ashpërsim të masave për shkelësit e rregullave në trafik, dhe aktualisht është duke u shqyrtuar nëpër komisionet e përhershme, para se të miratohet në lexim të dytë. "Këtë vit kemi humbur 104 qytetarë në aksidente komunikacioni, duke përfshirë edhe këmbësorë. Ne si shoqëri dhe si shtet nuk kemi asnjë qytetar për të humbur, veçanërisht për shkak të pakujdesisë së dikujt apo mosrealizimit të detyrave të zyrtarëve tanë", ka thënë ai.

Ministri Sveçla ka thënë se ligji i ri, nëse miratohet, parasheh dyfishim të gjobave, konfiskim të patentëshoferëve dhe dyfishim të pikëve, dhe se barra kryesore do të rëndojë mbi pronarin e makinës. "Përmes teknologjisë do t'i penalizojmë pronarët veturave, atyre veturave që bëjnë shkelje në trafik, e dënimet do të dërgohen në mënyrë të automatizuar te pronarët", ka pohuar ai.

Mes të tjerash, Sveçla ka përmendur se mesatarja e vdekjeve në trafik, në 21 vjetët e fundit, shkon në 133. Ai u ka bërë thirrje prokurorisë dhe gjykatave për të vendosur masa më të rrepta për shkelësit, dhe zbatim të rregullave dhe ligjeve, pa kompromis, nga zyrtarët policorë.



INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-SË SI “ORGANIZATË TERRORISTE”? (16)

Deklarata Politike numër 7 i hapi dyert e diplomacisë

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë “Epokës së re”, në vazhdimin e pjesës së gjashtëmbëdhjetë, ka folur për Deklaratën politike nr. 7, të datës 13 gusht 1998, ku Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së publikoi emrat e përfaqësuesve politikë. Ai ka treguar se krijimi i Drejtorisë Politike kishte për qëllim ta administronte dimensionin politik të luftës çlirimtare dhe në funksion të qartësimit se kush e përfaqëson UÇK-në. “Publikimi i emrave të përfaqësuesve politikë hoqi një numër dilemash që shtroheshin qoftë gjatë konferencave të shtypit me gazetarë të medie të ndryshme ndërkombëtare, qoftë në zgjerimin e kontakteve me diplomatë të vendeve të ndryshme”, ka thënë Bardhyl Mahmuti. Në këtë intervistë ai flet edhe për pakënaqësitë brenda LPK-së sa iu përket emrave se kush do të duhej ta përfaqësonte UÇK-në në takime me diplomatët e huaj

kanë bindjen se janë lënë anash në çastet vendimtare të një procesi për të cilin kanë dhënë kontribut, si do të reagonit ju?

Bardhyl Mahmuti: Nëse jeni dakord, për ta ruajtur aspektin kronologjik të zhvillimeve të ngjarjeve, për këtë çështje do të përgjigjem kur të flasim për përfaqësimin e delegacionit të UÇK-së në Konferencën e Rambujesë.

“Epoka e re”: Dakord! T’i kthehemi Drejtorisë Politike të UÇK-së. Në Deklaratën Politike nr. 7, të datës 13 gusht 1998, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së publikoi emrat e përfaqësuesve politikë, në mesin e të

cilëve ishit edhe ju. Çfarë mund të thoni lidhur me këtë deklaratë?

Bardhyl Mahmuti: Dihet se, përpos në rastet kur pushteti është në duar të një junte ushtarake, në të gjitha rastet e tjera organizimet e mirëfillta ushtarake drejtohen nga struktura civile politike dhe jo anasjelltas. Krijimi i Drejtorisë Politike kishte për qëllim ta administronte dimensionin politik të luftës çlirimtare dhe në funksion të qartësimit se kush e përfaqëson UÇK-në u lëshua kjo deklaratë. Duke u nisur nga ajo se Shtabi i Përgjithshëm ishte organi që bënte njoftimin zyrtar në emër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, edhe deklaratat politike u lëshuan në emër të këtij organi.

Publikimi i emrave të përfaqësuesve politikë hoqi një numër dilemash që shtroheshin qoftë gjatë konferencave të shtypit me gazetarë të medie të ndryshme ndërkombëtare, qoftë në zgjerimin e kontakteve me diplomatë të vendeve të ndryshme. Në rrafshin e brendshëm, krijimi i Zyrës së UÇK-së në Prishtinë, nga simboli i rezistencës sonë kombëtare, Adem Demaçi, shënoi rezultatin më të madh, sepse ua ofroi mundësinë konkrete atyre që ishin të interesuar t’i kontaktonin përfaqësuesit e UÇK-së në

PRISHTINË, 20 DHJETOR -

“Epoka e re”: Nga bashkëbisedimi i deritanishëm del se mbajtja fshehtë e përfaqësimit të UÇK-së në takime me diplomatët amerikanë kishte krijuar pakënaqësi të një numër udhëheqësish të LPK-së. A kanë ndikuar këto pakënaqësi që të përshpejtohet bërja publike e emrave të përfaqësuesve politikë të UÇK-së?

Bardhyl Mahmuti: Mendoj se pakënaqësitë nuk lidhen me atë se nuk ishin të informuar për emrat e personave që përfaqësonin UÇK-në në takime diplomatike, por për mënyrën si ishin anashkaluar në procesin e përzgjedhjes se kush do të fliste në emër të saj. Fakti se edhe një çerek shekulli pas asaj periudhe vazhdojnë ta trajtojnë si “komplot” moszgjedhjen e Drejtorisë Politike

të UÇK-së nga organet drejtuese të LPK-së dëshmon se motivet e pakënaqësive janë gjetiu.

“Epoka e re”: Mendoni se ambicite individuale të veprimtarëve të tjerë të LPK-së për ta përfaqësuar ata UÇK-në kanë ndikuar në pakënaqësitë e tilla?

Bardhyl Mahmuti: Është e mundshme, sepse ambicia për ta përfaqësuar një projekt të caktuar është tërësisht legjitime për çdo veprimtar që mobilizohet rreth një kauze politike. Duke qenë pjesë aktive e procesit të krijimit dhe të mbështetjes së UÇK-së, çdo anëtar i LPK-së ka pasur të drejtë të ketë ambicie ta përfaqësojë politikisht. Mirëpo historia është ajo që ka ndodhur dhe vlerësimet duhet të jenë të sakta lidhur me zhvillimet e

ngjarjeve në kontekstin e asaj kohe. Ajo që për mua është e papranueshme lidhet me mënyrën e prezantimit të atyre ngjarjeve në libra autorialë, artikuj apo intervista të disa veprimtarëve. Përqendrimi i vëmendjes në atë se kush e përfaqësoi UÇK-në në takimet diplomatike dhe mospërmendja e rezultateve të këtyre takimeve nuk është qasje objektive e realitetit të atëhershëm, por prezantimi i njëanshëm që lë në heshtje thelbin e asaj përse bëhen takimet e kësaj natyre: rezultatin!

“Epoka e re”: Nëse e përmbysim këndvështrimin dhe viheni në pozitën e atyre që



Kurti thotë se numri i të rinjve të punësuar këtë vit ishte mbi 60 mijë

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Nën organizimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të mërkurën është mbajtur Konferenca për Rininë 2023. Në këtë konferencë u paraqit politika e re qendrore karshi rinisë, gjatë së cilës pati sesione interaktive, demonstrime dhe diskutime. Kryeministri Albin Kurti në fjalën e tij ka kujtuar Muajin e Rinisë në gusht të këtij viti, Panairin e Punës e sukseset e rinisë në film, art, sport, biznes dhe teknologji. Ai ka thënë se roli i shtetit është ta përcjellë talentin dhe potencialin me mbështetje direkte, siç është edhe Strategjia Shtetërore për

Rininë. “Me Strategjinë Shtetërore për Rininë kemi hartuar dokumentin kryesor orientues afatgjatë për qeverinë karshi rinisë, ku secila ministri e institucion ka përcaktuar rolin e vet. Përveçse është strategji që na orienton drejt zhvillimit, është edhe një mjet reforme për politikëbërje ndërsektoriale për rininë, për herë të parë në vendin tonë”, u shpreh kryeministri.

Pavarësisht prej vështirësive dhe defekteve në sistemin arsimor, kryeministri Kurti tha se janë duke punuar në reforma, siç është arsimit dhe aftësimi profesional, arsimimi falas në nivelin e lartë

publik dhe dhënia e bursave për notë mesatare të lartë, pesë mijë bursave të tjera për studime brenda dhe jashtë vendit, si dhe bursave për vajzat në fushat e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe të matematikës. Më tutje, kryeministri përmendi se në fillim të vitit 2021 ishin 28 293 të rinj të punësuar, kurse në fund të korrikut numri i të punësuarve ishte 60 884, arritje kjo e mundësuar edhe përmes platformës së punësimit “SuperPuna”, programit “Kosova Generation Unlimited” dhe programit “Komunat për të rinjtë”. Ndërkaq Parkun e Inovacionit dhe

Trajnimit në Prizren dhe Parkun e Teknologjisë Digjitale në Bernicë i cilësoi hapësira të veçanta për kreativitet dhe inovacion. “Anëtarësimi i Kosovës në Organizatën Ndërkombëtare EYCA do të sjellë benefite brenda dhe jashtë Kosovës për të gjithë të rinjtë tanë, pa dallim, nën moshën 30-vjeçare”, tha kryeministri, teksa shtoi se me liberalizimin e vizave dhe përparimin në procesin e anëtarësimit në Këshillin e Evropës janë në prag të mobilitetit të shtuar dhe lidhjes më të afërt me Evropën. Sipas tij, nëpërmjet programeve në shkolla publike po bëjnë

shtrirjen e artit, sportit dhe vullnetarizmit për generatat e reja në komunën e Prishtinës, Gjilanit, Skenderajt, Pejës, Mitrovicës, Prizrenit, Ferizajt dhe Kamenicës. “Unë jam i bindur se nuk ka asgjë më të rëndësishme që mund të bëjmë si qeveri sesa ta përgatitim generatën e ardhshme për zhvillim dhe për udhëheqje të vendit tonë”, ka thënë kryeministri Kurti, duke u bërë thirrje të rinjve të kujdesen e të punojnë bashkë për t'i ndihmuar vetes, njëri-tjetrit dhe shtetit.

I pranishëm në këtë konferencë ishte dhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku.



Betohen 17 vullnetarët e rinj të Korpusit të Paqes në Kosovë

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Pas përfundimit të trajnimit dhjetëjavësh për gjuhë, kulturë dhe trajnim profesional, janë betuar 17 vullnetarët e rinj të Korpusit të Paqes në Kosovë.

Në betimin solemn të këtyre vullnetarëve, ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey Hovenier, tha se deri më tani kanë shërbyer mbi 200 vullnetarë në Kosovë. “Pres që ju ta përfaqësoni këtë mundësi.

Besoj shumë në ju sepse ju do të jeni në jetët e të tjerëve. Jam tejet i bindur se edhe ata do të kenë ndikim te ju. Jam i përfshirë shumë në raportet bilaterale. Ju dëshiroj të gjithë juve një sukses të jashtëzakonshëm dhe pres që me padurim t’ju vizitojë në vendet tuaja”, tha Hovenier.

Në këtë ceremoni mori pjesë edhe presidentja Vjosa Osmani, e cila i uroi mirëseardhje grupit të tetë të vullnetarëve në Kosovë. “Mirëserdhët në një tokë të

pasur dhe në vendin me mikpritje! Sot jam e emocionuar ta mirëpres grupin e tetë. Tani jeni pjesë e një komuniteti. Puna juaj shkon shumë përtej detyrave të përditshme. Ndikimi i shërbimit tuaj në buzëqeshjen e fëmijëve. Këto janë gjurmët e vërteta të grupit tuaj. Lidhja juaj tejkalon lidhjet diplomatike”, tha Osmani. Ndërsa drejtoresha e Korpusit të Paqes në Kosovë, Carolyne Siganda, ka paraqitur 17 vullnetarët.



Kosovë. Ndërsa në rrafshin ndërkombëtar na mundësoi ta krijojmë Grupin Diplomatik të UÇK-së me përfaqësues në qendrat vendimmarrëse të BE-së dhe në ShBA.

“Epoka e re”: Përveç juve, kush bënte pjesë në Grupin Diplomatik të UÇK-së?

Bardhyl Mahmuti: Që të ishim sa më efikas, për Zvicër, ku ishte selia e

Kombeve të Bashkuara, u caktuan Ramadan Avdiu, Jashar Salihu, Bilal Sherifi dhe Agush Buja; për Norvegji, që në atë kohë udhëhiqte OSBE-në nëpërmjet ministrit të Punëve të Jashtme, Knut Vollebæk, u caktua Nufri Leka; për Gjermani dhe Austri: Sabri Kiçmari, Rexhë Ibërde maj dhe Mujë Rugova; për Danimarkë: Ibrahim Xhemajli; për Britani të Madhe: Pleurat Sejdiu dhe për ShBA: Dino Hasanaj, ndërkaq

unë mbuloja edhe Francën dhe Belgjikën për shkak të zotërimit të gjuhës frënge.

“Epoka e re”: Përveç heqjes së dilemave se kush e përfaqëson UÇK-në, çfarë efektesh konkrete pati ky veprim?

Bardhyl Mahmuti: Në çastet më kritike kur populli shqiptar i Kosovës ballafaqohej me ofensivën e forcave të armatosura serbe që

zbatonin projektin e gjenocidit, publikimi i përfaqësuesve politikë të UÇK-së hapi dyert për takime diplomatike në shtetet më me peshë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Krahas kësaj, interesimi i madh i gazetarëve të huaj mundësoi mbajtjen e qindra konferencave me gazetarë në Prishtinë, Gjenevë, Paris, Bruksel, Bon, Vjenë, Londër, Kopenhagë, Oslo etj. Si rezultat i një pune të

larmishme politike, diplomatike dhe mediatike, arritëm ta ndryshojmë perceptimin që ishte krijuar për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në kuadër të institucioneve politike ndërkombëtare. Në këtë kontekst, më 23 shtator 1998, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën 1199, që shënoi një ndryshim cilësor lidhur me qëndrimin ndaj UÇK-së. (Muhamet Mavraj / Vijon)

Ministria e Kulturës dhuron 1 500 libra për bibliotekën e komunës së Podujevës

PODUJEVË, 20 DHJETOR - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit i ka dhuruar 1 500 libra bibliotekës së komunës së Podujevës. Ky donacion

vjen në kuadër të përkushtimit të vazhdueshëm për pasurimin e fondeve me libra të bibliotekave të qyteteve të Kosovës nga MKRS-ja. Drejtori

Kulturës në komunën e Podujevës, Pajtim Balaj, ka falënderuar Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për këtë donacion dhe ka

shprehur zotimin për angazhim të mëtutjeshëm të komunës për t'i plotësuar kërkesat dhe nevojat e lexuesve llapjanë.




Kurti viziton ekspozitën "Bebëzat e mallit" dedikuar fëmijëve të vrarë, të zhdukur dhe të prekur nga lufta në Kosovë

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka vizituar ekspozitën "Bebëzat e mallit", të fotografit Korab Krasniqi dhe kuratorës Vesa Sahatçiu, dedikuar fëmijëve të vrarë, të zhdukur dhe të prekur nga lufta në Kosovë.

Kurti ka theksuar se, krahas së qenit një hapësirë e posaçme e përkujtimit, kjo ekspozitë e hapur në Ministrinë e Drejtësisë është edhe ftesë për reflektim rreth mënyrës se si e mendojmë dhe përfaqësojmë humbjen individuale a kolektive. "Mirënjohje e falënderim për bashkërendimin e përpjekjeve të institucioneve dhe partnerëve tanë që kanë mundësuar

realizimin e këtij projekti. Ngjarje të këtilla, përveç se mbledhin kujtime dhe e ndajnë dhimbjen, i shërbejnë edhe kujtesës sonë kolektive për të shkuarën, për të mos e harruar kurrë atë. Për ta nderuar dhe lartësuar kujtimin e fëmijëve të vrarë dhe të zhdukur gjatë luftës, Qeveria e Republikës së Kosovës është e angazhuar në projektin për memorialin dedikuar atyre. Liria jonë i ka rrënjët te të rënë për liri. Vrasjet e fëmijëve në Kosovë janë krimet më të tmerrshme të Serbisë. Andaj e kemi obligim, për lirinë dhe paqen që e gëzojmë, për drejtësinë që e synojmë që kurrë mos t'i harrojmë", ka theksuar Kurti.



Hapet Qendra për Angazhimin e Komuniteteve në qytetin e Mitrovicës

MITROVICË, 20 DHJETOR - Në qytetin e Mitrovicës u shënuar hapja zyrtare e Qendrës për Angazhimin e Komuniteteve (QAK), një iniciativë e cila u realizua përmes bashkëpunimit të suksesshëm midis komunës së Mitrovicës dhe Projektit Integra.

Drejtori i Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit në këtë komunë, Elvis Feka, ishte i pranishëm

gjatë ceremonisë së hapjes dhe shprehu kënaqësinë e tij për këtë hapësirë të re që do të shërbejë si një burim i rëndësishëm për gratë dhe vajzat e riadhesuara. Kjo qendër synon ta nxisë pjesëmarrjen e tyre aktive në shumë lloje aktivitete, duke përfshirë ofrimin e mundësive të arsimit, trajnimit dhe seminareve. Përveç kësaj, QAK-u do të organizojë tubime sociale

dhe ngjarje të ndryshme për të krijuar një mjedis inkurajues dhe mbështetës për komunitetin. Drejtori Feka ka theksuar se ky hap ka një impakt të madh në përmirësimin e jetës së grave dhe vajzave të riadhesuara në këtë rajon, duke ndihmuar në forcimin e tyre nëpërmjet zhvillimit të aftësive dhe krijimit të mundësive të reja për ata që janë në nevojë.

Zyrtarizohet Këshilli i Pacientëve në Drenas

Drenas, 20 dhjetor - Drejtoresha e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Drenas, Lumnije Krapa, së bashku me Komisionin për Përzgjedhjen e Këshillit të Pacientëve, kanë pritur në takim anëtarët e Kryesisë së Këshillit të Pacientëve të komunës së Drenasit.

Drejtoresha e këtij dikasteri, Krapa, ka falënderuar Komisionin për Përzgjedhjen e Këshillit të Pacientëve për punën e suksesshme të kryer me përkushtim dhe profesionalizëm gjatë të gjitha fazave procedurale

të përzgjedhjes së anëtarëve të asamblesë, kryesisë dhe kryetarit të Këshillit të Pacientëve. "Kryetares dhe anëtarëve të kryesisë u uroj punë të mbarë dhe të suksesshme si dhe ua ofroj bashkëpunimin e plotë të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale si dhe QKMF-së", ka thënë Krapa.

Këshilli i Pacientëve u themelua në mes të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të komunës së Drenasit dhe organizatave partnere AQH dhe PRAK.



Nis asfaltimi i rrugës "Bajram Bahtiri" në Prishtinë

Prishtinë, 20 dhjetor - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se ka nisur

asfaltimi i rrugës "Bajram Bahtiri", së cilës i janë shtuar edhe dy korsi të reja me shtegun për biçikleta.

"Po investojmë në një nga arteriet e rëndësishme të Prishtinës sonë", ka shkruar Rama në "Facebook".



IKD dhe FOL: Komisioni i Venecias s'i përkrahu ndryshimet e MD-së për rritjen e përkohshme të anëtarëve të KPK-së

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Komisioni i Venecias, në opinionin e publikuar më 18 dhjetor 2023 për Projektligjin e ri për Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK), nuk i ka mbështetur ndryshimet e reja sa i përket rritjes së përkohshme të numrit të anëtarëve në KPK në 19 anëtarë deri në janar të vitit 2026, ndryshime këto të propozuara me versionin e ri të Projektligjit për KPK, pas ndryshimeve të bëra nga Ministria e Drejtësisë. Sipas Projektligjit, deri më 11 janar të vitit 2026 KPK-së parashihet t'i shtohen edhe tetë anëtarë joprokurorë të zgjedhur me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi. Megjithatë, rritja e përkohshme nuk është përkrahur nga opinioni i 18 dhjetorit 2023 të Komisionit të Venecias ku, ndër të tjera, ky opinion thekson se: "Një Këshill prej 19-anëtarësh me kohë të plotë në një shtet me pak më shumë se dyqind prokurorë duket tepër i madh. Megjithatë, nëse kjo është arsyeja, nuk është e qartë se mbi çfarë parimi ligjvënës propozon rritjen e anëtarësimit në mënyrë kaq dramatike vetëm për ta ulur atë në mënyrë drastike pas vetëm dy vjetësh". [CDL-AD(2023)043, par 65]. Kjo nuk është hera e parë që Komisioni i Venecias nuk rekomandonte rritjen e numrit të anëtarëve të KPK-së në një vend të vogël si Kosova. Njëjtë kishte rekomanduar edhe në opinionin e muajit tetor 2021 lidhur me draftligjin për KPK-në: "KPK do të bëhej shumë e madhe (mbi më shumë se 20 anëtarë), në raport me numrin e vogël të prokurorëve në Kosovë. Kjo zgjidhje sigurisht se do të ishte shumë e kushtueshme..." [CDL-AD(2021)051, Kosova, par. 61]. Komisioni i Venecias nuk e konteston faktin që ka rrezik të korporatizimit në përbërjen aktuale të KPK-së megjithatë,

sipas Komisionit, shtimi i tetë (8) anëtarëve joprokurorë në KPK rrit rrezikun e politizimit të Këshillit, pasi anëtarët shtesë që zgjedhen nga Kuvendi do të mund të zgjedhen nga shumica qeverisëse. "Edhe nëse ndryshimi i përbërjes mund të thuhet se është projektuar si një masë e jashtëzakonshme e vetme për ta eliminuar kulturën e korporatizimit, një ndryshim i tillë po futet në një klimë polarizimi, do të jetë funksional vetëm për një periudhë të shkurtër kohore, më pak se dy vjet në skenarin më të mirë, është i mbushur me rreziqe bllokimesh dhe politizimi dhe krijon dyshimin se "KPK-ja e zgjeruar" do t'i nënshtrohet një ndikimi të konsiderueshëm politik përpara se të krijohet "KPK e reduktuar". [CDL-AD(2023)043, par 62]. Se propozimi i MD-së ishte në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Strategjinë për Sundimin e Ligjit dhe vetë opinionet e Komisionit të Venecias ishte paralajmëruar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) përmes komenteve të dërguara në MD në maj të 2023-s, dhe komenteve të dërguara grupit punues në qershor 2023. Analiza dhe komentet e IKD-së janë pothuajse identike me komentet dhe rekomandimet e ofruara nga vetë opinionin i Komisionit të Venecias që u publikua para disa ditësh. Për më tepër, IKD dhe Lëvizja FOL kishin reaguar edhe publikisht me reagimin e 17 korrikut 2023, ku theksohej se përbërja me numër kaq të madh të anëtarëve të KPK-së nuk është hasur as në vendet e rajonit e as më gjerë dhe se kjo zgjidhje ishte në kundërshtim me opinionet e Komisionit të Venecias. Tutje, IKD dhe FOL kishin kundërshtuar edhe çështjen e kuorumit ku, sipas Projektligjit, kuorumi deri më 11 janar të vitit 2026 formohet me gjysmën e anëtarëve të zgjedhur të Këshillit



[Neni 21.3. i Projektligjit]. Në rast se të gjithë anëtarët e Këshillit zgjedhen, kuorumi formohet me dymbëdhjetë (12) anëtarë. Ky rregull zbatohet deri më 11 janar të vitit 2026 [Neni 21.3. i Projektligjit]. Kjo sipas IKD-së dhe FOL rrezikonte skajshmërisht politizimin e Këshillit, duke përfshirë rrezikun për bllokim të tërësishëm të vendimmarrjes, pasi nëse zgjedhen të gjithë anëtarët joprokurorë, atëherë kuorumi do të formohet me 12 anëtarë të KPK-së, që në çdo rast do të krijonte një varësi nga shumica qeverisëse. Për të mos ardhur deri të një bllokadë në vendimmarrje, ku interesat e ngushta të asnjë grupi nuk do të mbizotëronin, në opinionin e dytë, Komisioni i Venecias kishte rekomanduar që ligjvënësi kosovar, në koordinim me partnerët e tjerë, të përcaktojë parametra specifike të mekanizmave kundër-blokadë, që KPK të mund të marrë vendime edhe kur anëtarët prokurorë dhe joprokurorë nuk mund të arrijnë kompromis, e që në rastin konkret ky rekomandim i Venecias nuk ishte adresuar nga MD në Projektligjin e ri, as në përbërjen prej 19 anëtarëve as kur KPK do të mbetej vetëm me shtatë (7) anëtarë pas vitit 2026. [CDL-AD(2022) 006, Kosova, par 15]. Edhe lidhur me këtë çështje,

Komisioni i Venecias në opinionin e fundit ka theksuar se çështja e kuorumit, edhe nëse zgjedhen të gjithë anëtarët e KPK-së, mund të rezultojë lehtësisht në një paralizë të KPK-së, ku ekziston rrezik i konsiderueshëm i bllokimeve nëse anëtarët joprokurorë të emëruar nga Kuvendi zgjedhin të mos marrin pjesë në mbledhje, duke paralizuar kështu veprimtarinë e KPK-së. Sipas Komisionit të Venecias, për ta eliminuar mundësinë e bllokimeve, është rekomanduar që ligji të parashikojë masa disiplinore më të rrepta dhe efektive për mospjesëmarrje efektive në aktivitetet e KPK-së pa arsytim të vlefshëm. [CDL-AD(2023)043, par 68]. Tutje, sa i përket zgjedhjes së tre anëtarëve joprokurorë nga Kuvendi, Komisioni i Venecias ka rekomanduar që të gjendet një zgjidhje e cila do ta siguronte kontributin e ekspertëve dhe institucioneve të pavarura në procesin e përzgjedhjes. Komisioni nuk është bindur se mënyra dhe procedura e përzgjedhjes së tre anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi ka trajtuar thelbin e rekomandimit të mëparshëm, i cili kërkonte të sigurohej një përbërje pluraliste e KPK-së me qëllim për ta shkurtuar rrezikun e politizimit në zgjedhjen e anëtarëve joprokurorë.

Ky propozim, sipas Komisionit, do të duhet të përpunohet më tutje për të vendosur një ekuilibër të drejtë midis rrezikut të korporatizimit në një KPK të dominuar nga anëtarët prokurorë dhe rrezikut të politizimit të anëtarëve joprokurorë të zgjedhur nga Kuvendi. IKD dhe Lëvizja "FOL" në reagimin e bërë me 17 korrik 2023 kishin theksuar se dispozitat e Projektligjit të ri për KPK nuk ishin në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Strategjinë për Sundim të Ligjit dhe Opinionet e Komisionit të Venecias, duke konsideruar se ndryshimet e reja paraqisnin politizim objektiv të Këshillit. Si rrjedhojë, sipas IKD-së, këto manovrimet ishin vështirë të kalueshme në Gjykatën Kushtetuese, nëse eventualisht edhe ky Projektligj i nënshtrohet vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese me përmbajtjen që e ka aktualisht. Në anën tjetër, duhet theksuar se IKD, pas vënies në konsultim publik të këtij Projektligji nga Ministria e Drejtësisë, kishte dërguar komente në lidhje me këtë projektligj, duke ofruar një zgjidhje adekuate dhe të përshtatshme lidhur me përbërjen e anëtarëve të KPK-së në të ardhmen, në harmoni me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese ku me vendimin e kësaj të fundit veçse është humbur mundësia e shkurtimeve. Pas opinionit të Komisionit të Venecias, IKD dhe FOL rekomandojnë që të merren parasysh rekomandimet dhe konstatimet e dhëna nga opinionin i fundit i Komisionit të Venecias në mënyrë që të mos përsëriten gabime të ngjashme dhe të ketë vonesa të panevojshme, ku potencialisht edhe Projektligji i ri do ta ketë fatin e njëjtë sikurse i kaluari duke mos kaluar filtrin e Gjykatës Kushtetuese nëse dërgohet në këtë të fundit.

Lansohet udhëzuesi për zhvillimin e kurrikulës së programeve për Universitetin e Prishtinës



PRISHTINË, 20 DHJETOR - Universiteti i Prishtinës, nën përkrahjen e projektit "Heras Plus", ka bërë lansimin e udhëzuesit për zhvillimin e kurrikulës së programeve për Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", udhëzues ky që mundëson krijimin e një kurrikule të mirëstrukturuar që fokusohet në të menduarit kritik, nxitjen e inovacionit dhe përgatitjen e studentëve për nevojat e tregut. Në fjalën e tij, rektori i UP-së, Qerim Qerimi, ka theksuar rëndësinë e krijimit të dokumentacioneve të tilla që kontribuojnë në përsosmërinë akademike. "Ky udhëzues nuk

është thjesht një dokument, është një testament për vizionin tonë kolektiv. Një plan që fuqizon komunitetin tonë akademik t'i formësojë përvojat transformuese të të mësuarit", ka thënë Qerimi. Ndërsa udhëheqësi i ekipit në "Heras Plus", Aqim Emurliri, ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit me UP-në dhe përkushtimin që "Heras" ka në ofrimin e mbështetjes për sigurimin e cilësisë. Prorektorja për Akreditim, Cilësi të Mësimin dhe Çështje të Studentëve, Njomza Lullaku, ka theksuar se krijimi i udhëzuesve të tillë shërben në fuqizimin e stafit akademik dhe

arritjen e cilësisë. "Krijimi i udhëzuesit të tillë mundëson që të krijohen kurrikula dhe përvoja arsimore që tejkalojnë kufijtë tradicionalë, duke nxitur një kulturë përsosmërie dhe inovacioni. Udhëzuesi është dëshmi e përkushtimit tonë për të nxitur një përvojë arsimore që ushqen të menduarit kritik, kreativitetin dhe inovacionin", ka thënë ajo. UP-ja ka falënderuar të gjithë ata që kanë kontribuar në krijimin e këtij udhëzuesi, me theks Zyrën për Zhvillim Akademik për punën dhe iniciativën, prodekanët dhe koordinatoret për zhvillim akademik.

Mbahet konferenca vjetore e Ministrisë së Industrisë: Qeveria, platformë ndihmuese për zhvillimin e sektorit privat

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Organizuar nga Ministria e Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë, është mbajtur konferenca vjetore, në të cilën janë paraqitur Strategjia për Zhvillim Industrial dhe Instrumentet Mbështetëse për Bizneset. Kryeministri Albin Kurti gjatë fjalës së tij në këtë konferencë tha se angazhimi dhe përkushtimi i qeverisë për mbështetjen e ndërmarrjeve është fuqizuar tutje me Strategjinë e parë për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Biznesit 2030, e miratuar nga qeveria në këtë vit. Ai theksoi se gjatë këtij viti përkrahja për industrinë prodhuese me eksporte është rritur ndjeshëm dhe Qeveria e Kosovës ka mbështetur Fondin Kosovar për Garanci Kreditore, mbështetje që u është bërë bizneseve në kuadër të pakos së ringjalljes ekonomike, me masën 2.1, subvencionimi i kredive investuese. Si rezultat i saj, ai theksoi se raporti i eksporteve ndaj importeve është përmirësuar nga 1 me 9 sa ka qenë në 1 me 6 sa është aktualisht, e ku vlera e mallrave në eksport për periudhën janar-nëntor 2023 arriti në 756.9 milionë apo 139 % më shumë se në vitin

2019, që është viti i fundit parapandemik. Gjithashtu, kryeministri përmendi edhe nivelin e punësimit në sektorin privat, i cili është rritur përmes subvencionimit për bizneset, përmes masës 1.8 "Qeveria për Familjet" dhe masës 1.3 "Mbështetja për punësim të grave", dhe platformës së punësimit për të rinjtë nën moshën 25-vjeçare, "SuperPuna". Kryeministri Kurti shtoi se kanë hedhur hapat dhe themelet për konsolidimin e progresit afatgjatë e të qëndrueshëm të vendit, por "potenciali ynë zhvillimor ndonjëherë shkon edhe përtej parashikimeve". "Kosova është vendi i të rinjve dhe i mundësive të reja, i progresit dhe i shpresës. Krejt indikatorët ekonomikë janë më shumë sesa vetëm numra e statistika, çfarë i përmenda më përpara. Janë pikënisje e një të ardhme të ndritur dhe një rrugëtimi afatgjatë drejt të mirës publike, shpërndarjes së barabartë dhe një shoqërie sa më gjithëpërfshirëse. Sepse qeveria dhe qeverisja jonë e përbashkët është për të gjithë, pa lënë asnjëri prapa", tha ai. Duke i falënderuar të gjithë për angazhimin, kontributin që kanë bërë me ndërmarrjet e tyre, në



vështirësitë që i dimë e që nuk i dimë, Kurti tha se Qeveria e Kosovës është infrastrukturë, është platformë ndihmuese për zhvillimin, rritjen dhe fitimin e sektorit privat në Republikën e Kosovës, që bart barrën kryesore të punësimit në shoqërinë dhe

vendin tonë. Ndërkaq, ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, tha se ky vit, përtej sfidave të shumta, është përcjellë me rezultate të preکشme, të cilat kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në ambientin e të

bërit biznes, zhvillimin e politikave industriale tregtare, zhvillimin e ndërmarrësisë dhe inovacionit, mbikëqyrjen e tregut, mbështetjen e prodhuesve vendorë dhe promovimin dhe përkrahjen e investimeve dhe eksporteve.

Komuna e Gjilanit mbështet kërkesën për lirim të bizneseve nga taksa komunale për vitin 2023

GJILAN, 20 DHJETOR - Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) i komunës së Gjilanit, në mbledhjen e së mërkurës, nën drejtimin e Kushtrim Kadriut, kryesues i Kuvendit, i ka dhënë mbështetje rekomandimit të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik për lirim të bizneseve nga taksa komunale për vitin 2023. Në njoftimin për medie bëhet me dije se në takim u tha se lirimi i bizneseve nga taksa komunale, në këtë kohë të krizës globale, e cila ka përfshirë edhe vendin tonë, do të ndikojë në përballimin e situatës së krijuar dhe përmirësimin e klimës në ekonominë lokale. "Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik vlerëson se kriza ka paralizuar sektorët jetikë të ekonomisë, si transportin, ndërtimin, shërbimet në fushën e hotelarisë, gastronominë, prodhimin si dhe sektorë të tjerë



kyçë në zhvillimin ekonomik lokal. Po ashtu, KPF ka rekomanduar për Kuvendin edhe planin lokal të veprimit për barazi gjinore 2024-2026, planin e punës

të ekipit për të Drejtat e fëmijëve 2024-2026, sikurse edhe propozim-vendimin për miratimin e Planit të punës të Kuvendit për vitin 2024 si dhe

orarit të mbledhjeve të rregullta të Kuvendit dhe Komiteteve për vitin 2024", thuhet në njoftim. Njëherësh, KPF ka analizuar dhe rekomanduar për Kuvend edhe

propozimin për përcaktimin e vlerës së qirasë dhe bonuseve të banimit në dy programe sociale. "Për Kuvend u rekomanduan edhe raporti i komisionit për dezinfektim, raporti i komisionit për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave në procesin e emërtimit të rrugëve dhe numërimit të adresave, raporti i komisionit për ndarjen e bursave për studentë si dhe propozimi për funksionalizimin e punës së komiteteve, të cilat u vlerësuan të nevojshme për funksionimin sa më të mirë të Kuvendit. Përkrahjen e KPF-së e mori edhe kërkesa e Hendikosit për ndihmë, ndërkaq propozimet e përfaqësuesit të LDK-së sa u përket nominimeve për çmimet 'Qytetar Nderi' dhe 'Nderi i Qytetit' u rekomanduan në komisionin përkatës për shqyrtim dhe vlerësim", thuhet në njoftim.

AKB-ja kërkon nga qeveria ta themelojë bursën e kapitalit për vitin 2024


PRISHTINË, 20 DHJETOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka mbajtur takim të rregullt të fundvitit, në të cilin janë diskutuar dhjetë pika që ishin në rendin e ditës. Në mesin këtyre dhjetë

pikave ishte edhe Ligji i ri i Administratës Tatimore të Kosovës, Ligji i Fondit Sovran në Kosovë, tregtia e brendshme në Kosovë dhe raporti i aktiviteteve të AKB-së. Gjithashtu, AKB-ja ka kërkuar nga Qeveria e

Kosovës të procedojë sa më shpejt Ligjin për Bursën e Kapitalit në vitin 2024 si mundësi e re e zhvillimit ekonomik, vendor dhe ndërkombëtar ashtu siç e kanë shumë vende në Ballkan dhe në Evropë.



Revolucionari i shkencës: Kush ishte Galileo Galilei



Në cilësinë e "babait" themelues në fushën e fizikës dhe astronomisë, Galileo Galilei është i njohur për kontribute të panumërta në shkencë. Mendimtari italian, përdori një qasje metodike matematikore për studimin e Universit, dhe frymëzoi metodën shkencore moderne, që mbetet ende sot baza e kërkimit shkencor edhe 380 vjet pas vdekjes së tij.

Rishtë e tij në fushën e lëvizjes dhe gravitetit, janë po aq të jashtëzakonshme, dhe kanë hedhur themelet për fizikën e sotme, duke e bërë atë një nga shkencëtarët më të mëdhenj të të gjitha kohërave. Por të gjitha këto kontribute janë eklipsuar nga vëzhgimet e tij astronomike, të cilat zbuluar për herë të parë njollat në Diell, krateret në Hënë dhe yjet në të gjithë Rrugën e Qumështit, për të mos përmendur zbulimin e tij monumental se si kozmosi rrotullohet rreth Diellit.

"Unë zbulova në qiell shumë gjëra, të cilat nuk ishin parë para epokës sonë" - shkroi Galileo në vitin 1615. Në fakt, ai e ndryshoi mënyrën se si njerëzit e perceptonin botën. Ja cilat janë disa nga faktet më intriguese për jetën dhe karrierën e tij, që mund të mos i kenit ditur.

Emri dhe mbiemri tingëllojnë enkas të ngjashëm

Ai lindi në Toskanë të Italisë në vitin 1564, një kohë kur prindërit u vinin shpesh djemve të tyre emra personalë, të frymëzuar nga identifikuesit e tyre tradicionalë të familjes. Në fakt, paraardhësit e Galileos në fakt përdorën termat "Galileo" dhe "Galilei" në mënyrë

të ndërsjellë si mbiemër gjatë gjithë viteve.

Edhe pse tingëllojnë e çuditshme, njerëzit në këtë kohë i perceptonin si mjaft fleksibël rregullat e vendosjes së emrave. Shumica e italianëve në atë kohë, duke përfshirë Galileon, e prezantonin veten me një emër të vetëm, të cilin herë pas here e plotësonin me profesionin, qytetin e origjinës, emrin e babait ose mbiemrin tradicional të familjes.

Ishte një përfaqësues i vërtetë i Rilindjes

Gjatë moshës madhore, Galileo punoi si astronom, fizikant, filozof, shpikës dhe matematikan. Ai i tregoi disa nga këto aftësi që fëmijë, madhe edhe në disa fusha artistike. Kështu mësoi gjithçka rreth muzikës nga babai i tij, Vinçenzo Galilei, që punonte si muzikant dhe kompozitor oborri. Po ashtu ai mori seriozisht në konsideratë karrierën e piktorit. Në fakt, më vonë Galileo iu bashkua Akademisë së Arteve të Vizatimit në Firence, dhe do të vazhdohej të kështillohej piktorët më të mirë të kohës.

Shkencëtari u largua nga universiteti

Për shkak të inteligjencës së tij të jashtëzakonshme, Galileo u dërgua të studionte në Universitetin e Pizës në moshën 16-vjeçare. Atje, i riu u regjistrua fillimisht si student i mjekësisë, por u magjeps gjithnjë e më shumë nga matematika. Por në vitin 1585, braktisi studimet për shkak të vështirësive financiare. Ai vazhdoi të studionte matematikën në mënyrë të

pavarur dhe si mësues deri në vitin 1589, kur ai u kthye triumfalisht në atë universitet, këtë herë si një profesor me kohë të plotë i matematikës.

Ai ishte i njohur si një eksperimentet e tij praktike

Leksionet e Galileos për matematikën, mekanikën dhe astronominë tërhoqën shumë vëmendje. Në fakt, një nga studentët e Galileos, Vinçenzo Viviani, tregoi më vonë se turma të mëdha njerëzish ndiqnin eksperimentet e tij nëpërmjet hedhjes së sendeve të ndryshe nga kulla e famshme e Pizës. Ai vërtetoi se shpejtësia e rënies së tyre, ishte e pavarur nga pesha e tyre. Por më vonë nisi të debatonte me studiuesit e tjerë, të cilët u ofenduan për shkak se profesori po minonte vetë teorinë, që dikur kishte mësuar në shkollë. Në vitin 1592, kontrata e Galileos në Universitetin e Pizës skadoi, dhe studiuesi shkoi në Universitetin e Padovës, ku punoi nga viti 1592 deri në vitin 1610.

Nuk u martua asnjëherë, por krijoi një familje

Gjatë gjithë Epokës së Rilindjes, studiuesit dhe akademikët martoheshin rrallë. Edhe Galileo nuk bëri përjashtim. Gjithsesi ai ishte i lidhur me Marina Gamban, me të cilën pati 3 fëmijë: Virxhinia, Livian dhe dhe Vinçenzon. Dy vajzat u bënë murgesha në manastirin e Shën Mateos në Arçetri, ndërsa djali pati një karrierë si muzikant.

Ishte një shpikës pjellor

Galileo vlerësohet për disa shpikje të rëndësishme, përfshirë termoskopin (një pararendës i termometrit të sotëm që tregon luhatjet e temperaturës), por dhe busullave ushtarake. Ndërkohë shpiku edhe makinën llogaritëse që u përdor për shumëzime dhe pjesëtim, dhe për gjetjen e rrënjëve katrore dhe në kub. Galileo i shiti këto shpikje për të plotësuar pagën e tij si profesor.

Përmirësoi shumë teleskopin

Në vitin 1609, Galileo mësoi për një shpikje në Holandë, që i bënte objektet e largëta të dukeshin shumë më afër. Studiuesi nisi menjëherë të krijonte diçka të ngjashme. Edhe pse ai nuk ishte i pari që modeloi teleskopin, astronomi e përmirësoi atë për t'i zmadhuar objektet 20-30 herë. Vëzhgimet e Galileos zbuluan se shumë më tepër yje ishin shpërndarë nëpër qiell sesa pranohej më parë; se sipërfaqja e Hënës ishte e thepisur dhe e mbuluar me kraterë; dhe se Dielli përmbante disa njolla të errëta. Këto zbulime sugjeruan për herë të parë se bota qiellore ishte larg nga të qenit e përsosur.

Po ashtu Galileo ishte i pari që vëzhgoi një unazë e çuditshme që rrethon Saturnin, 4 hëna satelitore lëvizin rreth Jupiterit, dhe që Venusi kalon nëpër faza që pasqyrojnë atë të Hënës. Këto vëzhgime ishin shumë të domosdoshme për të shkatërruar teorinë e atëhershme mbizotëruese, që pretendonte se universi ishte i përqendruar rreth Tokës.

U përplas ashpër me Kishën (por jo me vetë katolicizmin)

Mbështetja e tij gjithnjë e më e hapur për "Heliocentrizmin" (Dielli ndodhet në qendër të sistemit), pati disa pasoja serioze. Në atë kohë, Kisha Katolike donte të mbronte modelin tradicional të kozmosit. Ndaj në vitin 1616, ajo e denoncoi Heliocentrizmin si "marrëzi dhe absurditet", pasi dukej se binte në kundërshtim me disa pasazhe të Biblës.

Për këtë arsye, Galileo e shmangu këtë temë publikisht deri në vitin 1632, kur ai botoi "Dialogo" në lidhje me dy sistemet kryesore botërore, dhe ku mbështeste Heliocentrizmin. Galileo u gjykua menjëherë nga Vatikani, dhe u dënua me arrest shtëpie për një kohë të pacaktuar. Gjithsesi studiuesi mbeti një besimtar i devotshëm në jetën e tij personale. Ai u rrit si katolik, dhe madje mendoi në një moment të niste karrierën si klerik.

Ai u verbua (por jo nga Dielli)

Galileo vazhdoi të punonte dhe të shkruante gjatë kohës që ishte në arrest në shtëpinë e tij pranë Firences. Pikërisht gjatë kësaj kohe, nisi të turbullohej dhe shikimi i tij. Në vitin 1638, astronomi u verbua plotësisht. Ndonëse në atë kohë mendohej se verbëria e tij vinte nga shikimi i Diellit me sytë të lirë, kjo gjendje ishte shkaktuar ndoshta nga katarakti dhe glaukoma. / Discover Magazine – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Ndërron jetë në moshë të re trajneri Ilmen Bajra

PRIZREN, 20 DHJETOR - Ka ndërruar jetë në moshën 33-vjeçare trajneri i basketbollit, Ilmen Bajra. Lajmin e hidhur e ka konfirmuar një nga klubet në të cilin punoi, "KB Prizreni". "Klubi basketbollistik Proton Cable Prizreni shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes Bajra dhe gjithë komunitetit të basketbollit. Ikja e hershëm në amshim është

një humbje e madhe për ne dhe basketbollin. Trajneri Bajra me sukses drejtoi skuadrën e Bashkimit, ishte pjesë e përfaqësueses njëherit edhe gjysmë sezone ishte në stafin e trajnerëve edhe te skuadra jonë. Thellësisht të pikëlluar do e kujtojmë Illmenin si shembull i punës, pozitivitetit e një miku që gjithmonë do jetë në zemrat tona", thuhet në

postimin e KB Prizreni në "Facebook". Bajra kishte punuar në disa skuadra të Kosovës, si Bashkimi e Rahoveci, derisa ishte edhe ndihmës te KB Prizreni. Suksesi më i madh i të ndjerit ishte titulli kampioni me KBF Bashkimi në vitin 2018. Ai së fundmi punonte trajner në skuadrën gjermane "Bad Homburg".

Drita fiton derbin ndaj Ballkanit, shkurtohet dallimi në pesë pikë

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Drita ka shënuar fitore të madhe në derbin ndaj Ballkanit me rezultat 2-1. Kjo ndeshje është zhvilluar të mërkurën në Gjilan. Ishte ndeshje e mbetur nga java e tretë për shkak të pjesëmarrjes së Ballkanit në Ligën e Konferencës. Trajneri Zekirija Ramadani është ndarë shumë i kënaqur me fitoren e arritur në këtë derbi, ndërsa i ka lavdëruar futbollistët për karakterin e treguar. "Padyshim që jam i lumtur edhe për rezultat, por edhe për qasjen në lojë, pasi ta kesh rivalin direkt dhe të pësosh gol dhe ta përmbysësh rezultatin ndaj Ballkanit, është meritë e madhe e futbollistëve që treguan karakter. Në pjesën e dytë nuk lejuam të na rrezikohet porta, por edhe e menaxhuam rezultatin, pasi e vetnija mundësi e Ballkanit ishin

goditjet standarde. Me këtë fitore do të kemi një pushim më të mirë dhe me këtë fitore rritet oreksi edhe te skuadrat e tjera", ka thënë Ramadani. Skuadra kampione në fuqi kaloi e para në epërsi, kur në minutën e shtatë të ndeshjes, Bajram Jashanica e shfrytëzoi një tollvi në zonën e Dritës dhe e dërgoi topin në rrjetë për rezultatin 0-1. Vendasit u rikthyen në lojë në minutën e 29. Muharrem Jashari e shërbeu për mrekulli Almir Ajzerajn i cili me kokë asistoi deri te Blend Baftiu që nga afërsia realizoi për 1-1. Në fund të pjesës së parë, Blerim Krasniqi me një gol të bukur e kaloi Dritën në epërsi. Pjesa e dytë nuk prodhoi gola të tjerë dhe Drita mori maksimumin nga kjo ndeshje e rëndësishme për vijimin e kampionatit, duke e bërë më shumë interesante garën për titull në Superligë. "E dinim se na priste një ndeshje e vështirë sidomos



ndaj Dritës që ka një ekip shumë të fortë. Kemi pasur mungesa të shumta dhe ato ndikuan shumë në lojë. Përveç mungesave, kishim edhe ngarkesa të mëdha për shkak të orarit të ngjeshur.

Këta janë faktorë që ndikuan në humbjen tonë por, krahas kësaj, Drita e meritoi fitoren dhe e përgëzoi", ka thënë Glen Daja, i cili e drejtoi Ballkanin në mungesë të trajnerit Ilir Daja që

mungoi për shkak të kartonëve. Tash Drita renditet në vendin e dytë me 34 pikë, derisa Ballkani është në vendin e parë me 39 pikë, por ka një ndeshje më pak të zhvilluar.

Kuka për Evropianin që u mbajt në Prishtinë: Kjo është fitorja më e madhe e Kosovës



PRISHTINË, 20 DHJETOR - Më 16 dhjetor për herë të parë në Kosovë u organizua një Kampionat Evropian i Xhudos, i cili në fund u mbyll në mënyrën më të mirë të mundshme, me plot katër medalje nga katër xhudistët që përfaqësuan shtetin tonë. Akil Gjakova u stolis me medaljen e artë, kurse Dardan Cena, Nora

Gjakova dhe Distria Krasniqi morën medalje të bronzit. Reagimet ishin të shumta nga shumë personalitete vendore. Ato nuk munguan as nga trajneri i ekipit të xhudos së Kosovës, Driton Kuka, i cili ka thënë se ky Evropian në Prishtinë ishte fitorja më e madhe e Kosovës. "Publiku në sallë i shkëlqyeshëm, mikpritja

shqiptare për sportistë e zyrtarë nga shtetet pjesëmarrëse në çdo cep të vendit ishte e mrekullueshme. Shumë prej tyre kanë ardhur duke menduar që vendi ynë po vendnumëron me zhvillim, por janë kthyer me përshtypjet më të mira! E kësaj radhe kjo është fitorja më e madhe e Kosovës!", ka shkruar Kuka në "Facebook".

Çeku: Fillimi i ndërtimit të stadiumit nacional nis vitin e ardhshëm, ende s'dihet lokacioni

Prishtinë, 20 dhjetor - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ka folur lidhur me ndërtimin e stadiumit kombëtar. Çeku ka bërë me dije se vitin e ardhshëm do të përcaktohet përfundimisht lokacioni për ndërtimin e këtij

stadiumi. Gjithashtu, i pari i MKRS-së në T7 ka thënë se beson që edhe ndërtimi i tij do të nisë vitin e ardhshëm. "Për stadiumin nacional merret vendimi përfundimtar vitin e ardhshëm për lokacion. E kemi si obligim kontraktual për

Lojërat Mesdhetare. E kemi marrë sivityet të drejtën e organizimit dhe aty stadiumi nacional është pjesë e kontratës dhe duhet ta bëjmë. Por, atyre u kemi thënë se një herë duhet bërë master-plani, që përcakton lokacione për infrastrukturën e

re", ka thënë ai. "Ka pasur nisma për dy lokacione, Drenas dhe Bernicë. Mund të jetë njëra nga këto dy lokacione. Ndoshta master-plani do të na japë një tjetër lokacion. Vitin e ardhshëm besoj se nis ndërtimi", ka deklaruar ministri Çeku.



Cikalleshi: Do të bëjmë përfaqësim dinjitoz në Evropian

Tiranë, 20 dhjetor - Kombëtarja e Shqipërisë synon surprizën në "Euro 2024" pavarësisht se përballë do të ketë skuadra të forta si Italia, Spanja dhe Kroacia. Në një intervistë të dhënë, sulmuesi i Kombëtares, Sokol Cikalleshi, u shpreh i

bindur se ekipi i Silvinhos do të bëjë paraqitje dinjitoze në Gjermani. "Janë tri ndeshje që janë mjaft interesante dhe të bukura për t'u luajtur. Do ta shijojmë dhe them se kombëtarja gjithmonë ka bërë ndeshje të bukura me ekipet e

forta. Shumicën e rasteve kemi pasur probleme me ekipet e vogla. Jam i sigurt se do të bëjmë përfaqësim shumë dinjitoz dhe ndeshje të mira", ka thënë Cikalleshi. Shqipëria luan ndeshjen e parë ndaj Italisë më 15 qershor në

stadiumin "Dortmund", ndërsa më 19 qershor do të përballë me Kroacinë në stadiumin "Volksparkstadion Hamburg". Ndeshja e fundit e grupit do të jetë ajo ndaj Spanjës, që do të luhet më 24 qershor në stadiumin "Dusseldorf Arena".



De Biasi ëndërron Kosovën: Do të doja shumë ta përshkruaj të njëjtën rrugë që e kam bërë më Shqipërinë

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Trajneri i njohur italian Gianni De Biasi në emisionin "Mirëmëngjesi Kosovë" në RTK ka folur rreth zërave për ta marrë drejtimin e Kosovës. "Dardanët", pas largimit të Primoz Glihas, ende nuk kanë gjetur "timonierin" e ri. Në mesin e disa emrave që mund ta marrin drejtimin e Kombëtares sonë është edhe ish-trajneri i Shqipërisë, Gianni De Biasi, i cili kishte bërë historinë duke e dërguar për herë të parë skuadrën kuqezi në Kampionatin Evropian. Strategu italian ka thënë se nuk është kontaktuar nga Federata e Futbollit e Kosovës, por ai thotë se është i gatshëm ta marrë drejtimin e Kosovës.

"Nuk ka asnjë kontakt zyrtar. E kam takuar presidentin Ademi në Shqipëri, por nuk kemi biseduar për këtë çështje. Nëse do ta drejtojë Kosovën do të isha i kënaqur", ka thënë De Biasi.

Ai thotë se Përfaqësuesja e Kosovës ka skuadër me potencial të mirë. De Biasi thekson se do të dëshironte që të bëjë të njëjtë rrugë që e kishte bërë më parë me Shqipërinë. "Është një skuadër shumë e mirë dhe që ka potencial. Do të doja shumë të përshkruaj të njëjtën rrugë që e kam bërë më Shqipërinë. Natyrisht se në futboll nuk është gjithçka e arritur,



por premiset ekzistojnë për diçka të mirë", ka thënë ai. Ai ka folur edhe për kualifikueset e Kosovës në "Euro 2024", ku Kosova dështojë të kualifikohet në "Gjermania 2024". Sipas tij, "Dardanët" mund të kishin bërë më shumë por, sipas De Biasit, fillimi i ciklit ishte i vështirë për Kosovën. "E pati pak vështirë në fillim, e dyta ishin ekipe të forta në grup, por mund të bëhej më shumë. Me grupin e lojtarëve që ka Kosova, sigurisht se mund të arrihej më shumë", ka deklaruar De Biasi. Më tutje tekniku italian është i bindur se Kosova mund të ecë përpara sepse, sipas tij, është një grup i mirë i lojtarëve. Ai thotë se Federata e Futbollit e Kosovës vendos për trajnerin e ri të Kosovës. De Biasi shton se nuk është në

pyetje para.

"I njoh të gjithë lojtarët, edhe ata që nuk i njoh kam hyrë t'i shikoj. Kosova ka lojtarë të mirë dhe me një start të mirë dhe se vetëm duhet një shtyrje për ta çuar përpara. Duhet ta shtyjmë skuadrën, duhet ta shtyjmë federatën, zgjidhja është e tyre, sidoqoftë unë jam gati për ta marrë drejtimin e Kosovës, por cilido trajner që të vijë është mirë të bëhet zgjidhja më e mirë. Nuk është problem para", ka theksuar italianin, i cili së fundmi drejtoi Azerbajxhanin. De Biasi ka folur edhe për Kombëtaren e Shqipërisë, e cila do të pjesë e Evropianit 2024. Kuqezinjtë janë në grup me Italinë, Kroacinë dhe Spanjën. "Uroj më gjithë zemër që ta kalojnë grupin", ka përfunduar De Biasi.

Golden State ndal kryesuesit e Bostonit pas kohës shtesë, fitojnë Memphisi dhe Milwaukee

MILWAUKEE, 20 DHJETOR - Ekipi i Golden States fitoi me rezultat 132-126 ndaj Bostonit pas kohës shtesë në një ndeshje spektakolare mes dy ekipesh pretendente për titull. Edhe pse të gjithë titullarët e Bostonit realizuan mbi 10 pikë (White 30 pikë më i miri), kjo s'mjaftoi. Për Golden State u dallua Stephen Curry, autor i 33 pikëve. Fitore të rëndësishme arriti skuadra e Portlandit, që mundi me rezultat 109-104 Phoenixin.



Duranti realizoi 40 pikë, por që mbetën për statistikë, ndërsa për vendasit u dalluan Simonsi dhe Granti. Fitoi edhe ekipi i Milwaukee, që falë 40 pikëve të Damian Lillardit, mundi San

REZULTATET

New Orleans - Memphis	113-115
Milwaukee - San Antonio	131-119
Golden State - Boston	132-126
Portland - Phoenix	109-104

Antonion (131-119), duke qëndruar mes pretendentëve në Lindje. Fitore në sekondat e fundit korri ekipi i Memphisit, që triumfoi ndaj New Orleansit (115-113), sfidë ku u dallua Ja Moranti me 34 pikë.

SHKURT

Shefi i Ferrarit: Viti 2026, shansi i madh për ta ndalur dominimin e Red Bullit

Të gjitha skuadrat përpiqen ta ndalin dominimin e Red Bullit, por nuk e kanë të lehtë. 21 fitoret në 22 gara të këtij sezoni janë fakt se makina austriake është e paarritshme dhe ky dominim pritet të vijojë edhe vitin tjetër. Frederic Vasseur, shefi i Ferrarit, duke folur për të ardhmen, konfirmon se për "kokëkuqen" do të jetë e vështirë të arrijë Red Bullin. "Mundësia më e mirë është ta ndalim këtë cikël. Në Formula 1 sot garohet me cikle dhe tani është radha e Red Bullit. Këtë gjë e tregojnë 25 vitet e fundit të këtij sporti", ka thënë Vasseur. "Duke parë rregulloret, mendoj se duke nisur nga viti 2026 mund ta ndalim këtë cikël, kur të ndërtohen makinat e reja. Ne do të shohim se di do ta zhvillojmë makinën tonë në dy vitet që vijojnë, duke pasur si objektiv atë sezon. Natyrisht që ne nuk heqim dorë edhe nga sezoni që vjen", ka shtuar shefi i Ferrarit. "Tema më e rëndësishme për ne që duam ta kapim Red Bullin është viti 2026. Duhet të përgatitemi mirë për atë moment, pasi është një shans i mirë për ta rikthyer Ferrarin fitues që duam dhe njohim të gjithë", ka përfunduar Vasseur.

Reali interesohet për Icardin

Skuadra e Real Madridit e ka shtuar interesimin për ta transferuar Mauro Icardin nga Galatasaray. Sipas "Radio Marca", Reali po mendon të paguajë 8 milionë euro te klubi turk për huazimin 6-mujor të Icardit në Madrid. Forma e Joselu nuk po bind stafin drejtues të klubit spanjoll, teksa zgjidhja mund të jetë transferimi i ish-sulmuesit të Interit, i cili, në fakt, po kalon një sezon shumë të mirë në Turqi.

Courtois konfirmon mungesën në 'Euro 2024'

Thibaut Courtois ka bërë me dije se nuk do të luajë Kampionatin Evropian me Belgjikën për shkak të gjendjes fizike. Portieri i njohur këputi ligamentet e kryqëzuara të gjurit para disa muajsh dhe mungesa e tij në "Euro 2024" duket e pashmangshme. "Së pari do të më duhet të rikuperohem 100%. Më mirë të mos caktosh një datë. Për shkak të këtij dëmtimi nuk do të luaj Kampionatin Evropian. Nëse do të jem me fat, do të mund të luaj një ndeshje në maj, por kurrë nuk do të jem 100% siç duhet për një turne të madh si kampionati evropian", ka thënë Courtois. "Mendoj se është më mirë të jem i sigurt me Belgjikën. Nuk do të jem në portë nëse jam në 80% për sa kohë kemi portierë të tjerë të mirë. Do të la mënjatë krenarinë time dhe do të jem thjesht tifoz në qershor", ka deklaruar "gardiani" belg. Portieri i Real Madridit, Thibaut Courtois, ka luajtur jo pak për Kombëtaren e Belgjikës, por 102 ndeshje.

Mjeku i Brazilit: Neymari nuk do të jetë në Kupën e Amerikës

Neymari nuk do të mund të marrë pjesë në Kupën e Amerikës 2024, të planifikuar për në qershor dhe korrik në ShBA, për shkak të lëndimit të rëndë të pësuar në tetor, ka thënë mjeku i kombëtares braziliane. Ylli i

"Selecao" u lëndua gjatë humbjes 2-0 kundër Uruguait në Montevideo, në një ndeshje kualifikuese për Kupën e Botës 2026. Ai iu nënshtrua një operacioni në nëntor për këputje të ligamentit të kryqëzuar dhe

meniskut në gjurin e majtë. Duhet të paktën 9 muaj rehabilitim për t'u rikthyer në lojë, pas një lëndimi të tillë, nga më të rëndët për një futbollist, ka shpjeguar mjeku brazilian Rodrigo Lasmar, duke

përfunduar mundësinë që Neymari të marrë pjesë nga data 20 qershor deri më 14 korrik në kompeticionin që bashkon 10 kombëtares e Konfederatës së Futbollit të Amerikës së Jugut dhe 6 të Konfederatës së Futbollit

të Amerikës së Veriut, Amerikës Qendrore e Karaibeve. Mjeku i kombëtares braziliane, megjithatë, është besimplotë për shanset që 31-vjeçari, i cili luan për klubin saudit Al-Hilal, të luajë sërish në nivele të larta.



MITROVICA
KOMPANIA UJESJELLESË RAJONALE SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOĐ D.D.

Rruga e Liqenit p.n. - 40000 Mitrovicë

DATA: 21.12.23 NR: 1834

Duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 dhe Udhëzimin Administrativ Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik Nr.07/2017, Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë, shpallë:

K O N K U R S

(Për plotësimin e vendit të lirë të punës, punë provuese gjashtë (6) muaj, me mundësi vazhdimi)

I. Emërtimi i vendit të punës: **Bagerist (Ekskavatorist)**

Përgaditja profesionale: **Shkolla Fillore ose e Mesme**

Përvoja e punës: **Së paku 1 vit.**

Numri i kryerësve: **1.**

Kushtet të veçanta:

- Të jetë punëtor i kualifikuar Bagerist (Eskavatorist).

Paga Bazë: 494.37 Euro, sipas Rregullores mbi ndarjen e të ardhurave të KRU "Mitrovica".

Orari: 1 plotë.

Vendi i punës: KRU "Mitrovica" Sh.A Njësia Vushtrri

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat,
- Kryen projektimin e rjetit të objektit të ujësjellësit dhe kanalizimit,
- Bënë marrjen e urdhërësive për përdorimin e makinës me të cilën është i ngarkuar personalisht përdor sipas urdhërësës,
- Pastron dhe bënë lyerjen dhe mirëmbajtjen e makinës me të cilën është i ngarkuar,
- Punonjësi është i ngarkuar dhe është përgjegjës për mjete të cilat i përkasin makinës dhe është përgjegjës për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre,
- Punëtori i cili punon në këtë vend të punës është përgjegjës për kryerjen e punëve me urdhërin e përgjegjësit të tij,
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhërësës që merr nga Udhëheqësi/sja,
- Për punën që kryen i përgjigjet Shefit të Mekanizmit

Dokumentet e kërkuara:

Kandidatet e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin e Kompanisë dhe së bashku me këtë aplikacion të bashkangjesin edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Letër motivimi,
- Diploma e Shkolles së Mesme apo Deftesa e Shkolles Fillore (orgjinali nga kopja e noterizuar, kurse jashtë vendit duhet të jetë e nostrifikuar),
- Dëshmi nga gjykata kompetente që nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj,
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale,
- Dëshmi mbi eksperiencën e punës (trusti),
- Kopja e letërnjoftimit.

Mënyra e aplikimit:

- Aplikacionet mund të merren ueb-faqen e Kompanisë KRU "Mitrovica" Sh.A. në adresën: <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset/> si dhe fizikisht në zyrën për Burime Njerëzore, dhe të dorëzohen në të njëjtën zyrë së bashku me dokumentacionin përcjellës në formë fizike.
- Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit nga data **21.12.2023** deri me datën **04.01.2024**.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.
- Dokumentet e pranuar të aplikantëve në fotokopje nuk kthehen.

VËREJTJE: Kandidatët të cilët paraqesin aplikacionin e pa-plotësuar, apo nuk i bashkëngjisin dokumentet e kërkuara si në konkurs, aplikimet e tyre do të refuzohen dhe të njëjtë nuk do të i nënshtrohen procedurës së rekrutimit.



MITROVICA
KOMPANIA UJESJELLESË RAJONALE SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOĐ D.D.

Rruga e Liqenit p.n. - 40000 Mitrovicë

DATA: 21.12.23 NR: 1834

U skladu sa članom 8. Zakona o radu br. 03/L-212 i Administrativnog uputstva za regulisanje postupaka u vezi sa oglasom za radna mesta u javnom sektoru br. 07/2017, Regionalno vodovodno preduzeće „Mitrovica“ d.d. u Mitrovici, je objavila ovaj:

OGLAS ZA RADNO MESTO

(Za popunjavanje slobodnih radnih mesta šest (6) meseci probni rad sa mogućnošću produženja)

I. Naziv radnog mesta: **Bagerista**

Profesionalna kvalifikacija: Osnovna ili Srednja Škola

Radno iskustvo: Najmanje (1) godina

Broj pozicija: (1)

Posebni uslovi:

- mora biti kvalifikovan bagerista

Osnovna plata: 494.37 €, na osnovu Uredbe o raspodeli prihoda u RVP Mitrovica

Radno vreme: Puno

Radno mesto: **RVPM - Jedinica u Srbici**

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- može da obavlja zadatke sa punim radnom vremenom i bez ograničenja,
- izvodi projektovanje mreže objekta vodovoda i kanalizacije,
- prima naloge za korišćenje automobila kojim je zadužen i lično ih koristi po nalogu,
- čisti i radi farbanje i održavanje automobila za koje je zadužen,
- zaposleni je zadužen i odgovoran je za alate koji pripadaju automobilu i odgovoran je za njihovo skladištenje i održavanje,
- zaposleni koji radi na ovom radnom mestu odgovoran je za obavljanje poslova po nalogu svog pretpostavljenog,
- obavlja i druge poslove po nalogu koji dobije od Vode,
- za posao koji obavlja odgovoran je Vode Mehanizma

Potrebna dokumentacija:

Zainteresovani kandidati moraju popuniti prijavu Preduzeća i uz prijavu priložiti sledeću dokumentaciju:

- CV (Biografija),
- Motivaciono pismo,
- Diploma srednje škole ili Potvrda osnovne škole (overena kopija, dok diploma sa ustanove u inostranstvu mora biti nostrifikovana),
- Dokaz nadležnog suda da nije pod istragom, ne stariji od 6 meseci,
- Dokaz o stručnom usavršavanju,
- Dokaz o radnom iskustvu (trust),
- Kopija lične karte.

Način prijave:

- Prijave se mogu dobiti na sajtu Preduzeća RVP „Mitrovica“ d.d. na adresi: <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset/>, kao i fizički u Službi za ljudske resurse, i dostaviti istoj kancelariji zajedno sa pratećom dokumentacijom u štampanom obliku.
- Konkurs će biti otvoren 15 dana od dana objavljivanja od **21.12.2023 do 04.01.2024**.
- Prijave dostavljene nakon isteka roka se ne prihvataju.
- Prihvaćena dokumenta podnosiocima prijava u fotokopijama se ne vraćaju.

NAPOMENA: Kandidatima koji podnesu nepotpunu prijavu, ili ne prilože traženu dokumentaciju kao u oglasu za konkurs, prijave će biti odbijene i neće biti predmet postupka prijema.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Mecis" SH.P.K. me seli në Obiliq, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811976432 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Mecis" D.O.O. Obiliq, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811976432 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Mecis" L.L.C. with headquarters Obiliq, has come to the decision to quit its business: 811976432 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lumë's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Feride Maxhuni, shpall te pavlefshme 3 dëftesat e shkollës se mesme "Xheladin Deda".

- Jahir Hodaj, shpall te pavlefshme dëftesa e klasës 6,7,8 shkolla fillore "Migjeni", Mitrovicë.

- Jahir Hodaj, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore klasa 1,2,3,4,5 -shkolla "Bajram Curri" Prizren.

- Razita Kajtazi, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "Xheladin Deda".

- Sadik Sahiti, shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Harun Beka".

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

